



ZHVILLON PUNIMET KONFERENCA E 37-TË VJETORE NDËRKOMBËTARE E IOSCO-S

Konferenca u fokusua në arkitekturën e re financiare në epokën pas krizës, infrastrukturën e tregjeve financiare, integrimin e tyre dhe ecurinë e tregjeve të kapitaleve në ekonomitë e vendeve në zhvillim, si dhe rregullimin e instrumentave financiare.

Vijon në faqen 2

INTERVISTË E KRYETARES SË AMF-SË, ZJ. ENKELEDA SHEHI, DHËNË BOTIMIT PERIODIK XPRIMM.COM

Kryetarja e AMF-së, znj. Enkelelda Shehi, në maj 2012 dha një intervistë për publikimin online "Media Xprimm". Ky publikim realizohet nga një agjenci informacioni dhe marrëdhëniesh me publikun e specializuar në sigurime, risigurime dhe pensionet private me informacione për tregjet në të gjithë Evropën Qendrore dhe Lindore.

Vijon në faqen 4

VËSHTRIM MBI TREGJET

Tregu i sigurimeve për periudhën janar-prill 2012

Vijon në faqen 6

EDUKIMI I KONSUMATORIT

"Një nevojë kombëtare apo një bezdi e panevojshme?"

Prezantim i Z. Kun Ho Hwang, Kryetari i Forumit Ndërkombëtar për Edukimin e Investitorëve mbajtur në mbledhjen e 36-të Vjetore të IOSCO-s, prill 2011, në Afrikën e Jugut. (Material i përpunuar, nxjerrë nga faqja zyrtare e IOSCO-s, prill 2011).

Vijon në faqen 8

ZHVILLIME TË TJERA

"Mundësi për krijimin e një platforme të përbashkët tregtimi mes bursave të vendeve të rajonit" Vizitë pune në vendet e Balltikut në datat 6-12 maj 2012 organizuar nga Programi për Stabilitet Financiar (PFS Program) i USAID.

Vijon në faqen 12

Takim rajonal i Autoriteteve Mbikëqyrëse të Sigurimeve të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, si dhe Azisë Qendrore dhe Transkaukazisë.

8-10 maj 2012, Shkup, Maqedoni

Vijon në faqen 13

Roli i sektorit të sigurimeve në sistemin financiar dhe në ekonominë reale - Forumi Ndërkombëtar i Sigurimeve.

10-11 maj 2012, në Washington, SHBA

Vijon në faqen 14

"Mbikëqyrja e pensioneve për vendet e Evropës Qendrore, Lindore, Azisë Qendrore dhe Kaukazit".

10-11 maj 2012 Shkup, Maqedoni

Vijon në faqen 14

Takimi i tretë rajonal i mbikëqyrësve të tregjeve të sigurimeve të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore.

24 - 25 maj në Lubjanë, Slloveni

Vijon në faqen 15

"Mbrojtja konsumatore në sigurime, praktikat më të mira dhe standardet ndërkombëtare të IOPS-it".

31 maj - 1 qershor Tiranë

Vijon në faqen 16

TË REJA NGA RAJONI

GREQI: Tregues në rënie në sigurimin e anijeve

Vijon në faqen 17

RUSI: Viti 2011, ruhet tendenca rritëse

Vijon në faqen 17

BULLGARI: Viti 2011 dhe tendencat e ndryshme

Vijon në faqen 18

ZHVILLON PUNIMET KONFERENCA E 37-TË VJETORE NDËRKOMBËTARE E IOSCO-S

Konferenca u fokusua në arkitekturën e re financiare në epokën pas krizës, infrastrukturën e tregjeve financiare dhe integrimin e këtyre tregjeve, zhvillim e tregjeve të kapitaleve në ekonomitë e vendeve në zhvillim, si dhe rregullimin e instrumentave financiare.

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) zhvilloi gjatë periudhës 13 - 17 maj 2012 në Pekin, Kinë, Konferencën e 37-të Vjetore. Autoriteti i Mbrojtjes Financiare të Shqipërisë, si anëtar me të drejta të plota i kësaj organizate, u përfaqësua në këtë eveniment të rëndësishëm nga Znj. Enkeleda Shehi, Kryetare e Autoritetit, Znj. Miranda Ramaj, Anëtare e Bordit të AMF-së dhe Znj. Violanda Theodhori, Drejtore e Departamentit të Çështjeve Juridike.



Nga e majta në të djathtë:
Zj. Violanda Theodhori, Drejtore e Departamentit të Çështjeve Juridike dhe Zj. Enkeleda Shehi, Kryetare e AMF-së

Konferenca u fokusua në arkitekturën e re financiare në epokën pas krizës, infrastrukturën e tregjeve financiare dhe integrimin e këtyre tregjeve, zhvillim e tregjeve të kapitaleve në ekonomitë e vendeve në zhvillim, si dhe rregullimin e instrumentave financiare.

Konferenca arriti në përfundimin, se hapa të rëndësishëm janë ndërmarrë për të siguruar që IOSCO, si hartues i standardeve ndërkombëtare për rregullimin e tregjeve të letrave me vlerë:



Nga e majta në të djathtë:
Zj. Enkeleda Shehi, Kryetare e AMF-së;
Zj. Miranda Ramaj, anëtare e Bordit të AMF-së;
Zj. Violanda Theodhori, Drejtore e Departamentit të Çështjeve Juridike

- të jetë i strukturuar dhe i pozicionuar në mënyrë që të vazhdojë të ketë rolin drejtues në zhvillimin e standardeve rregullatore për tregjet kapitale;
- të ketë burimet e nevojshme për të marrë përsipër identifikimin e risqeve të zhvillimit të tregjeve të letrave me vlerë;
- të posedojë aftësinë për të përmbushur nevojat e anëtarëve të saj;
- të jetë i përgatitur për t'iu përgjigjur kërkesave të G20 dhe Bordit të Stabilitetit Financiar (FSB).

Gjatë konferencës u zhvilluan dhe mbledhjet e komiteteve të veçanta të IOSCO-s.

Bordi i ri tranzitor i IOSCO-s

Konferenca miratoi krijimin e një bordi tranzitor për të marrë funksionet e Komitetit Teknik, Komitetit Ekzekutiv dhe Bordit Këshillimor të Komitetit të Vendeve në Zhvillim. Kjo shkrimje e tre organizmave do të ndihmojë më mirë në procesin e vendimmarrjes, si dhe për t'i dhënë mundësi organizatës të luajë një rol më të gjerë në formatimin e kuadrit rregullues për tregjet e letrave me vlerë. Në këtë kontekst, IOSCO do të vazhdojë të kontribuojë në përpjekjet e vazhdueshme në reformën globale rregullatore.

Në mbledhjen e parë, të 32 anëtarët e bordit të tranzicionit, emëruan Z. Masamichi Kono si Kryetar të Bordit të ri të IOSCO-s. Z. Kono është Zëvendës Komisioner për marrëdhëniet ndërkombëtare pranë Agjencisë së Shërbimeve Financiare të Japonisë dhe që prej vitit 2011 ka qenë edhe Zëvendës Kryetar i Komitetit Teknik të IOSCO-s. Bordi caktoi edhe dy Zëvendës Kryetarë, Dr. Vedat Akgiray, Kryetar i Bordit të Tregjeve të Kapitaleve (CMB) të Turqisë dhe Z. Ethiopis Tafara, Drejtues i Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare pranë Komisionit të Bursës dhe Letrave me Vlerë të SHBA-së.

Për të rritur efektshmërinë e strukturës së re qeverisëse dhe drejtimin strategjik të organizatës, anëtarët e IOSCO-s diskutuan gjatë konferencës, nevojën për burime alternative të financimit të IOSCO-s. Financimi i ri do të shkojë në drejtim të shërbimeve të ofruara për anëtarët, duke përfshirë asistencën teknike, arsim, trajnim dhe hulumtim në çështjet globale të tregut të letrave me vlerë.

Komiteti i Vendeve në Zhvillim (EMC)

Në mbledhjen e Komitetit të Vendeve në Zhvillim u vlerësua se ekonomitë e këtyre vendeve përbëjnë disa nga ekonomitë me rritje më të shpejtë. Më tepër se 80% e vendeve anëtare të IOSCO-s janë pikërisht nga këto vende në zhvillim dhe madje edhe 10 nga këto vende bëjnë pjesë në Grupin e 20 ekonomive udhëheqëse në botë. Mbledhja theksoi se roli i këtij komiteti mbetet shumë i rëndësishëm dhe u vlerësua si një burim për fuqizimin e vetë IOSCO-s. Mbledhja ngriti një grup pune për të përcaktuar më saktë se cili do të jetë roli i Komitetit të Vendeve në Zhvillim në arkitekturën e re të IOSCO-s.

Struktura e re e Komitetit të Vendeve në Zhvillim

Bazuar në konsultimet e mëparshme me anëtarët e saj, IOSCO vendosi shkrijen e grupeve të punës të Komitetit Teknik dhe të Komitetit të Vendeve në Zhvillim. Struktura e re do të përmirësojë efektivitetin e Komitetit për politikën dhe vendosjen e standardeve, duke e bërë atë më efektive dhe gjithëpërfshirëse.

Rritja e Bashkëpunimit Ndër-Kufitar

IOSCO miratoi një rezolutë e cila lejon marrjen e masave më të rrepta për të inkurajuar bashkërendimin dhe zbatimin nga anëtarët, të cilët nuk e kanë nënshkruar ende Memorandumin Shumëpalësh të Mirëkuptimit (MMoU). Ky memorandum është një mjet i përdorur nga rregullatorët për të siguruar efektivitet, ruajtjen, sigurimin dhe forcimin e tregut të letrave me vlerë kudo në botë.

Nënshkruet të rinj të Memorandimit Shumëpalësh të Mirëkuptimit të IOSCO-s (MMoU)

Konferenca Vjetore e Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) në Pekin shënon 10 vjetorin e Memorandimit Shumëpalësh të Mirëkuptimit, si një instrument i përdorur nga rregullatorët e letrave me vlerë për të siguruar rregullimin efektiv global, ruajtjen dhe forcimin e tregjeve të letrave me vlerë në të gjithë botën. Katër anëtarë të IOSCO-s nënshkruan Memorandumin Shumëpalësh të Mirëkuptimit gjatë Mbledhjes Vjetore të Pekinit, duke e çuar në 86 numrin e vendeve nënshkruese. Nënshkruet e rinj janë autoritetet rregullatore dhe mbikëqyrëse financiare të Libanit, Perusë, Egjiptit dhe Mauritanisë.

IOSCO do të zhvillojë Konferencën Vjetore të 38-të në Luksemburg më 15 - 19 shtator 2013.

Konferenca Vjetore e Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) në Pekin shënon 10 vjetorin e Memorandimit Shumëpalësh të Mirëkuptimit, si një instrument i përdorur nga rregullatorët e letrave me vlerë për të siguruar rregullimin efektiv global, ruajtjen dhe forcimin e tregjeve të letrave me vlerë në të gjithë botën.

INTERVISTË E KRYETARES SË AMF-së, ZJ. ENKELEDA SHEHI, DHËNË BOTIMIT PERIODIK XPRIMM.COM


Kryetarja e AMF-së, znj. Enkelelda Shehi, në maj 2012 dha një intervistë për publikimin online "Media Xprimm". Ky publikim realizohet nga një agjenci informacioni dhe marrëdhëniesh me publikun e specializuar në sigurime, risigurime dhe pensionet private me informacione për tregjet në të gjithë Evropën Qendrore dhe Lindore. Qendra e saj ndodhet në Rumani. Kjo agjenci boton tre revista në gjuhën rumune dhe angleze, si edhe gjashtë botime periodike (newsletter) të dedikuara kryesisht tregut të sigurimeve ndër të cilat edhe xprimm.com.

(marrë me shkurtime)

Një nga ndryshimet më të rëndësishme ligjore me një ndikim të drejtpërdrejtë në tregun e sigurimeve në vend, ishte miratimi në korrik të vitit 2011 të Ligjit nr. 10455, datë 21.07.2011 "Për disa shtesa dhe ndryshime të Ligjit nr. 10.076, datë 2009/02/12, "Për sigurimin e detyrueshëm në të sektorin e transportit".

Një nga ndryshimet më të rëndësishme ligjore me një ndikim të drejtpërdrejtë në tregun e sigurimeve në vend, ishte miratimi në korrik të vitit 2011 i Ligjit nr. 10455, datë 21.07.2011 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10.076, datë 2009/02/12, "Për sigurimin e detyrueshëm në të sektorin e transportit". Këto ndryshime lejuan heqjen e regjimit të tarifave fikse dhe u lejuan shoqërive të sigurimeve të përcaktonin vetë tarifat e primeve duke i hapur kështu rrugën çmimeve të tregut të lirë. Kjo u pasua menjëherë me një rënie të fortë të çmimeve, i cili ndikoi në performancën e përgjithshme të tregut. AMF ka punuar për vite me radhë, për të zhvilluar infrastrukturën e duhur për procesin e liberalizimit të sigurimit MTPL dhe në këtë moment sfidat për periudhën e ardhshme kërkojnë vëmendje shumë më të madhe për këtë segment të veçantë të tregut, i cili në të njëjtën kohë është shumë i rëndësishëm, pasi përfaqëson 45% të të ardhurave të tregut. Në shtator 2011, filloi një projekt i përbashkët me Bankën Botërore, për të adresuar disa çështje afatshkurtra dhe afatgjata në përputhje me strategjinë e AMF-së. Projekti do të synojë të adresojë disa çështje të rëndësishme për të lehtësuar tranzicionin drejt një çmimi më efikas, i bazuar në risk.

Një nga aspektet më të rëndësishme është që AMF duhet të kenë mjetet e duhura për



Enkelelda Shehi, Kryetare e AMF-së

të siguruar që shoqëritë e sigurimeve, të ruajnë provigjionet e duhura për detyrimet që ato marrin përsipër, të konceptuar në dy mënyra:

- Hartimin e një procesi të verifikimit nëse provigjionet e dëmeve janë të përshtatshme për situatat e njohura dhe,
- Hartimin e një procesi për të siguruar që bizneset dhe risqet e rinovueshme janë të siguruar me çmime të pranueshme teknikisht.

Përveç kësaj, projekti do të trajtojë disa përmirësime që mund të bëhen në Qendrën e Informacionit të Sigurimit Motorik, duke u përqendruar në ndërtimin e sistemit bonus-malus në fazën e tanishme. Gjithashtu është duke

u zhvilluar një strategji për menaxhimin e numrit të personave të pasiguruar.

AMF ka përfunduar tashmë projektligjin për sigurimin i cili do të përafrohet me Direktivat e BE-së për sigurimin dhe do të mbështesë metodologjinë e re të mbikëqyrjes me fokus riskun. Gjatë vitit 2012, projektligji do t'i dërgohet për miratim Parlamentit.

Një vendim i rëndësishëm ishte edhe miratimi nga ana e AMF-së në mbledhjen e tetorit 2011, e metodologjisë së re të mbikëqyrjes bazuar në risk dhe Planin Strategjik të Zbatimit të saj. Kjo është një linjë veprimi strategjike afatgjatë, shumë e rëndësishme e cila do të zbatohet në tregun e sigurimeve. Si rezultat, zbatimi do të jetë gradual në mënyrë që ti lejojë tregut dhe mbikëqyrësit për të koordinuar veprimet e tyre dhe për të ndërtuar kapacitetet dhe infrastrukturën e nevojshme, për të lëvizur drejt një regjimi mbikëqyrje të bazuar në risk.

Duke ju referuar pyetjeve në lidhje me ndryshimin e psikologjisë së konsumatorëve dhe të kompanive të sigurimeve në kushtet e krizës globale, Kryetarja e AMF-së veçoi disa aspekte.

Disa nga ndryshimet më të rëndësishme që ndodhin në kohë krizash, në drejtim të strategjive të marketingut, lidhen me rishikimin e sistemeve të çmimeve, uljen e shpenzimeve administrative, si dhe uljen dhe vëzhgimin e vazhdueshëm të niveleve të autorizuar të shitjes. Disa shoqëri, gjithashtu zbatojnë politika më efektive të mbledhjes së primit dhe përzgjedhjes së riskut.

Gjatë 2012, siguruesit duhet të menaxhojnë me shumë kujdes

investimin dhe risqet në mënyrë që të mund të jenë elastikë për një ngadalësim të mundshëm në drejtim të të ardhurave të përgjithshme. Në kohë të vështira ekonomike, sigurimi është ndër shpenzimet e para që bizneset dhe individët kanë tendencë të ulin, kështu që tregu duhet të menaxhojë me shumë kujdes burimet e veta për të shmangur në masën maksimale të mundshme çdo luhatje të panevojshme në rezultatet teknike. Përzgjedhje të kujdesshme të riskut dhe çmimit, marrëveshje më të efektshme risigurimi apo strategji marketingu mund të jenë disa prej sfidave që do merren në konsideratë gjatë këtij viti.

Në aspektin e konsumatorit, konkurrenca në produktet vullnetare mund të bëjë që ata të përfitojnë pasi siguruesit do të kenë nxitje për të zhvilluar më shumë produkte cilësore në mënyrë që të rrisin nivelin e klientëve të tyre. Sigurimi privat shëndetësor qëndron ndër linjat e biznesit që është në rritje dinamike dhe ka arritur të përmbushë disa nga kërkesat e tregut.

Ne presim që 2012 të jetë një vit përgjithësisht i vështirë, në drejtim të rritjes së tregut. Një ngadalësim i mundshëm në aktivitetin ekonomik për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike aktuale, që po përjetojnë disa partnerë strategjikë tregtarë të Shqipërisë, mund të ketë ndikimin e tyre të tërthortë në aktivitetin ekonomik të vendit dhe si rezultat në disa portofole të caktuara të sigurimit. Gjithashtu mund të ndikohen edhe linja kryesore të biznesit që janë të lidhura drejtpërdrejt me aktivitetin e kreditimit të bankave dhe të investimeve infrastrukturore në vend. Nga ana tjetër, periudha e tranzicionit që vjen pas liberalizimit të MTPL-së gjithashtu mund të ndikojë në të ardhurat e përgjithshme gjatë vitit 2012.

Një vendim i rëndësishëm ishte edhe miratimi nga ana e AMF-së në mbledhjen e tetorit 2011, e metodologjisë së re të mbikëqyrjes bazuar në risk dhe Planin Strategjik të Zbatimit të saj.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Tregu i sigurimeve për periudhën janar-prill 2012


Në periudhën janar-mars 2012 vihet re një rritje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C, të marra së bashku, me rreth 875.52 milionë lekë, krahasuar me periudhën janar-mars 2011.

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-prill 2012 arritën shifrën 2,693,779 mijë lekë, përkundrajt 2,938,897 mijë lekë të realizuara në janar-prill 2011 ose 8.34 % më pak se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 56.48% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 43.52% të tregut. Përsa i takon tregjeve, në veçanti, kemi një rënie në masën

10.94% të sigurimeve të Jetës dhe një rënie prej 8.15% të sigurimeve të Jo-Jetës. Nga të ardhurat gjithsej të tregut 88.15% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës, 11.69 % nga veprimtaria e Jetës dhe 0.16% nga veprimtaria e risigurimit.

Në janar-prill 2012 u nënshkruan rreth 298,227 kontrata sigurimi, ose 26.99% më pak se në janar-prill 2011.


Struktura e tregut të sigurimeve, për janar-prill 2011



Volumi i primit të shkruar bruto, për janar-prill (2011-2012)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë Lekë)	
	2011	2012
janar-prill		
A) Sigurim i Jetës	353,555	314,890
B) Sigurim i Jo-Jetës	2,585,341	2,374,626
<i>Nga këto:</i>		
a) Sigurimi Detyrueshëm	1,273,443	1,172,198
b) Sigurimi Vullnetar (Jo-Jetë)	1,311,899	1,202,428
C) Risigurimi	-	4,262
TOTAL	2,938,897	2,693,779

Volumi i primit të shkruar bruto, për janar-prill 2011 (Jeta dhe Jo-Jeta)



Sigurimet e detyrueshme motorike

Në janar-prill 2012, sigurimet e detyrueshme motorike sollën 1,172,198 mijë lekë të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme për janar-prill 2012, arritën 868,406 mijë lekë, ose 17.62% më shumë se janar-prill 2011.

Në janar-prill 2012, primet e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin 226,206 mijë lekë, ose rreth 51.43% më pak se në janar-prill 2011. Kjo ulje e primit shkruar bruto Karton Jeshil lidhet me liberalizimin tregut të sigurimit të detyrueshëm në gusht të vitit 2011.

Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë janar-prill 2012 arritën në 77,587 mijë lekë, apo 11.77% më shumë se në janar-prill 2011.

Sigurimet vullnetare

Për janar-prill 2012, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 1,521,580 mijë lekë, ose 8.64% më pak se të ardhurat e janar-prill 2011.

Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës, me të ardhura 1,202,428 mijë lekë, vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe rreziqet natyrore me 52.29% të pasuara nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit me 18.52%, dhe nga sigurimi Kasko me 14.94 %, peshë më të ulët patën sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile, sigurimet e garancisë.


Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit, në janar-prill 2012, arritën në 222,651 mijë lekë, 33.83% më pak se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e klasës 1, sigurimi i aksidenteve me 53.71% të të ardhurave të këtij grupi.

Primet në sigurimet e jetës në janar-prill 2012 arritën në 314,890 mijë lekë, ose 10.94% më pak se në janar-prill 2011.

Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit


Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës ndahet ndërmjet shoqërive të sigurimit: Sigal Uniqa Group Austria, Sigma Vienna Insurance Group, Insig, Atlantik, Interbalkan, Albsig, Intersig dhe Eurosig. Sigal Uniqa Group Austria udhëhoqi tregun me 31.89 % të primeve.

Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, për janar-prill 2012 (Jo-Jeta)



Shoqëritë e mëdha të sigurimeve duhet t'i bëjnë produktet më të lehta për t'u kuptuar nga njerëzit, ato duhet t'i bëjnë produktet e tyre të përdorshme, me gjuhë të qartë, në mënyrë që të gjithë të mund t'i kuptojnë dhe jo të përdorin zhargone teknike.

Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, për janar-prill 2012 (Jeta)



Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë Sigal-Life Uniqa

Group Austria, Insig dhe Sicred. Sigal-Life Uniqa Group Austria udhëhoqi tregun me 40.53 % të primeve.

Dëmet

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar-prill 2012 kapë vlerën 1,070,717 mijë lekë, ose 56.71 % më shumë se në janar-prill 2012 . Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimit motorik me 571,616 mijë lekë, apo 53.39 % të totalit.

EDUKIMI I KONSUMATORIT

Një nevojë kombëtare apo një bezdi e panevojshme?

(Material i përpunuar, marrë nga konferenca e 36 Vjetore e IOSCO-s, në Afrikën e Jugut e nxjerrë nga faqja zyrtare e IOSCO-s, prill 2011)

http://ifie.org/pdfs/20110418_Chairman%20Speech_reviewed.pdf

**Prezantim i Z. Kun Ho Hwang
Kryetar, Forumi Ndërkombëtar për Edukimin e
Investitorëve mbajtur në mbledhjen e 36 Vjetore
të IOSCO-s, prill 2011 në Afrikën e Jugut.**

Forum i Ndërkombëtar për Edukimin e Investitorëve (IFIE) është krijuar në vitin 2005, si një aleancë e veçantë në të cilën marrin pjesë ofruesit e edukimit të investitorëve në sektorin privat dhe publik. Misioni i IFIE-së është zhvillimi dhe fuqizimi i programeve, politikave dhe praktikave të edukimit të investitorëve në mbarë botën. Për të arritur këtë objektiv, mes veprimtarive të shumta botërore dhe rajonale, IFIE ofron një rrjet për shkëmbimin e informacionit dhe përvojave më të mira. IFIE i ndihmon ofruesit e edukimit të investitorëve të jenë gjithnjë të informuar për trendet aktuale dhe praktikat më të mira në lidhje me programet e edukimit të investitorëve

dhe produktet e investimeve në tregjet financiare botërore.

Besojmë se askush nuk duhet ta vërë në dyshim vlerën e edukimit financiar. Në veçanti, pas krizës së fundit financiare botërore, edukimit financiar po i vihet gjithnjë e më shumë theksi në botë. Mendoj se kjo pasqyron mendimin se kriza është shkaktuar pjesërisht nga mungesa e njohurive financiare dhe nga edukimi i pamjaftueshëm financiar. Rëndësinë e edukimit financiar e theksojnë një sërë faktorësh. Ndër këto përfshihen ndryshimet e mjedisit financiar botëror, siç është futja e produkteve të sofistikuar, rritja e

krimit financiar dhe e krimeve të tjera. Në këtë listë, bëjmë mirë të fusim edhe rritjen e asimetrisë së informacionit, rritjen e jetëgjatësisë mesatare dhe rritjen e moshës mesatare të popullsisë.

Të gjendur përballë rritjes së mundësive për të zgjedhur dhe rritjes së rreziqeve në tregun e lirë, konsumatorëve u duhet edukim financiar në mënyrë që të jenë në gjendje të marrin vendime racionale. Kjo është sidomos e vërtetë ngaqë jo çdo produkt financiar mund të rregullohet si duhet.

Edukimi financiar është një prej instrumenteve më të efektshme për përmirësimin e nivelit të njohurive financiare të individëve dhe për të ndihmuar në parandalimin e krizave financiare. Nga këndvështrimi në nivel mikro, nga edukimi financiar përfiton mirëqenia e individëve. Nga këndvështrimi në nivel makro, prej saj përfiton zhvillimi i tregut dhe i ekonomisë. Nuk ka dyshim se programet, normat dhe praktikat financiare të shëndosha dhe të gjithanshme kanë rëndësi jetike për stabilitetin dhe vitalitetin e tregjeve të kapitalit.

II

Përkundër rritjes së rëndësisë së edukimit financiar, përhapja e tij lë për të dëshiruar, si rrjedhim, ky diskutim zhvillohet sot në mbledhjen e IOSCO-s.

Besoj se ka tre sfida madhore kundrejt zgjerimit të edukimit financiar.

Së pari, edukimi financiar kërkon kosto të larta. Më konkretisht, përgatitja dhe realizimi në vazhdimësi i programeve që mund të përmbushin nevojat e grupeve të ndryshme të njerëzve kushtojnë. Duke qenë se ekonomitë dhe tregjet vazhdojnë të rriten dhe të zhvillohen globalisht, lindin kosto të tjera shtesë për përditësimin e këtyre programeve, në përmbushje të nevojave

të reja. Një çështje e rëndësishme është edhe se kush duhet të jetë përgjegjës për financimin e një edukimi të tillë.

Së dyti, i njëjti program edukimi ndikon te njerëzit në mënyrë të ndryshme. Është e vështirë të dihet se kur dhe si do të realizohen efektet e programeve të edukimit.

Së treti, vlerësimi i edukimit të konsumatorëve përbën detyrë të vështirë. Nuk është asnjëherë e lehtë të vlerësohet mënyra me të cilën i arrijnë synimet programet e edukimit të cilat i justifikojnë kostot.

Mendoj se këto çështje janë arsyeja përse, ndonjëherë, vihen pikëpyetje mbi edukimin e konsumatorëve. Megjithatë, mendoj se nuk duhet t'i lëmë këto sfida të na pengojnë nga promovimi dhe zhvillimi i edukimit financiar të konsumatorëve.

III

Në shumë vende edukimi ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomive kombëtare dhe tregjeve të kapitalit. Meqë mendoj se Koreja është një shembull i mirë, do të doja të ndaja me ju përvojën e Koresë.

Në vitet 1960-1970, Koreja ka qenë një vend i varfër agrar, por tashmë renditet si ekonomia e 12-të më e madhe në botë. Të ardhurat për frymë të Koresë janë rritur me afro 230 herë gjatë këtyre 40 vjetëve, nga 87 dollarë në mbi 20 mijë dollarë.

Edhe pse kjo rritje e vrullshme mund t'u dedikohet shumë faktorëve, me besim mund të them se një forcë kryesore shtytëse ka qenë pasioni për arsim i popullit korean.

Aktualisht, rreth 80 për qind e atyre që kryejnë arsimin e mesëm në Kore regjistrohen në arsimin e lartë, që është ndër shkallët më të larta në botë.

Pas krizës së fundit financiare botërore, edukimit financiar po i vihet gjithnjë e më shumë theksi në botë. Mendoj se kjo pasqyron mendimin se kriza është shkaktuar pjesërisht nga mungesa e njohurive financiare dhe nga edukimi i pamjaftueshëm financiar.

Përqindja e analfabetizmit në Kore është thuhet zero, ndër më të ulëtat në botë. Po kështu, edukimi financiar është parë se është i efektshëm në zhvillimin e tregut të kapitalit. Me qëllim ofrimin e edukimit financiar sistematik dhe të efektshëm, është krijuar në vitin 2005, Këshilli i Koresë për Edukimin e Investitorëve (KCIE). KCIE është një organizatë jofitimprurëse, që shtrihet në të gjithë vendin, me bashkëfinancimin e shtatë organizatave, ku përfshihen entet rregullatore publike, shoqata e sektorit përkatës të ekonomisë dhe bursa. KCIE ofron një larmi programesh, jo vetëm për investitorët e përgjithshëm, por edhe për të rinjtë dhe ata që ndodhen në pozita të pafavorshme.

Kjo punë në Kore ka sjellë ndryshime pozitive në tregun e kapitalit në vend. Koreja është dëshmitare e një ndryshimi të strukturës sa i takon administrimit të pasurive familjare nga format e depozitave në format e investimeve. Për pasojë, tregu i kapitalit po bëhet një destinacion i rëndësishëm investimi për pasuritë e familjeve. Në përputhje me këtë ndryshim, tregu korean ka arritur rritje cilësore, duke u bërë më i qëndrueshëm dhe duke u orientuar drejt investimeve të diversifikuara afatgjata. Me fjalë të tjera, investitorët institucionalë po luajnë një rol më të madh në një treg, i cili dikur mbizotërohej nga investitorë spekulativë të transaksioneve me pakicë. Pra, unë besoj fuqimisht se është arsimi dhe edukimi ai që ka luajtur një rol qendror në zhvillimin e ekonomisë dhe të tregut të kapitalit në Kore.

IV

Për ta ofruar me efikasitet edukimin financiar, duhet të kemi një strategji kombëtare. Strategjia kombëtare ndihmon në ruajtjen e konsekuencës në politikën e edukimit dhe në bashkërendimin e ofruesve të ndryshëm. Mirëpo, është thuhet e

pamundur që edukimi i konsumatorëve të vendoset tërësisht nën kontrollin e shtetit e të enteve publike rregullatore. Vetëm sistemi shkollor nuk mjafton për t'u kujdesur tërësisht për edukimin e konsumatorëve në moshë të rritur. Nuk ka gjasa që qeveria t'i përmbushë nevojat e ndryshme të konsumatorëve individualë në mjedisin e sotëm të tregut, i cili ndryshon në mënyrë të vrullshme. Për rrjedhojë, qeveria dhe autoritetet publike bëjnë mirë ta përqendrojnë vëmendjen tek ngritja e një infrastrukture arsimore dhe hartimi i strategjive kombëtare të edukimit. Në këtë kuptim, organizatat vetërregulluese mund të jenë në gjendje të marrin përsipër një pjesë të përgjegjësisë për edukimin e investitorëve. Kjo qasje ka disa të mira.

Së pari, financimi i edukimit nuk do të mbulohej vetëm nga tatimpaguesit, por edhe nga sektori përkatës i ekonomisë.

Së dyti organizatat vetërregulluese janë më në gjendje t'i përgjigjen me shpejtësi dhe elasticitet mjedisit të tregut financiar që ndryshon në mënyrë të vrullshme. Kjo do të thotë se këto organizata janë në gjendje të ofrojnë edukim financiar që mund të plotësojë nevoja konkrete dhe të ndryshueshme të grupeve të ndryshme të synuara. Për më tepër OVR- të mund të punojnë për të bashkërenduar mes qeverisë dhe sektorit përkatës të ekonomisë, duke punuar, ndërkohë, në plotësim të edukimit financiar brenda sistemit arsimor. Në këtë mënyrë, organizatat vetërregulluese mund ta rrisin efektivitetin e edukimit financiar në tërësi.

Si përfitues të tregut financiar, emetuesit e regjistruar në bursë dhe investitorët institucionalë është mirë të angazhohen në edukimin e konsumatorëve. Shoqëritë e regjistruara në bursë janë përgjegjëse për dhënien e shënimeve shpjeguese transparente, të cilat i ndihmojnë

konsumatorët të marrin vendime financiare në bazë të informacioneve.

Investitorët institucionalë duhet të identifikojnë se çfarë informacioni u duhet klientëve të tyre individualë përmes sistemit “Njihe klientin”. Dhe ata duhet t’u japin klientëve informacion të mjaftueshëm për strukturën dhe risqet e produkteve të investimit financiar. Institucionet financiare duhet të kujdesen që informacioni të jepet në atë mënyrë në mënyrë që të jetë i lehtë për t’u kuptuar.

Në kuadër të nismës për rritjen e përgjegjësisë sociale të shoqërisë tregtare, këto subjekte mund të ofrojnë dhe financojnë programe edukimi.

Bashkëpunimi ndërkombëtar është thelbësor për zhvillimin e edukimit të konsumatorëve. Më konkretisht, është e rëndësishme të nxitet shkëmbimi i informacionit për programet dhe politikat e edukimit mes vendeve.

IFIE synon ta plotësojë këtë nevojë duke shërbyer si forum për ofruesit e edukimit të investitorëve në mbarë botën. Aktualisht, IFIE ka dy nënkomitete rajonale: Forumin e Azisë për Edukimin e Investitorëve (AFIE) dhe MENA-IFIE-në.

AFIE përfaqëson territoret e Azisë dhe Paqësorit, ndërsa MENA-IFIE përfaqëson Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut. Këto organe janë të përkushtuara për përmirësimin e edukimit të investitorëve në rajonet përkatëse.

VI

Theksojmë në maksimum rëndësinë që ka edukimi i konsumatorëve për tregun e kapitalit. Ai është një aspekt themelor i zhvillimit të tregut të kapitalit, sepse lidhet drejtpërdrejt me rritjen e besimit te tregu. Kur investitorët e humbasin besimin te tregu, duhet shumë punë për ta rifituar besimin, nëse rifitohet.

Në botën financiare të ditëve tona, e cila ndryshon në mënyrë të vrullshme, investitorët e edukuar janë shumë në gjendje të marrin vendimet e duhura dhe ta menaxhojnë riskun në mënyrë të efektshme. Vendimet e mbështetura në informacion ndihmojnë në sigurimin e shfrytëzimit efikas të burimeve, rritjen e efikasitetit të tregut dhe zhvillimin e ekonomisë.

Besoj në mënyrë të vendosur se edukimi i konsumatorëve është një nevojë kombëtare dhe se të gjithë ne duhet të mësojmë prej njëri tjetrit, të ndajmë përvojat tona dhe ta mbështetin njëri tjetrin në këtë aspekt. Ja sepse duhet të punojmë së bashku për promovimin e edukimit të konsumatorëve jo vetëm brenda vendeve tona, por edhe mes tyre.

Në veçanti, shpresoj se qeveritë, entet publike rregullatore, organizatat vetërregulluese dhe ofruesit e edukimit të investitorëve do ta fuqizojnë punën e përbashkët për të realizuar programe më të mira të edukimit financiar me më shumë pjesëmarrës. Besoj se kjo punë do të ndihmojë për ta kuptuar më mirë kapitalizmin dhe për ta forcuar demokracinë në mbarë botën.

Të gjithë bursat nga vendet e Evropës Juglindore, përfshirë Shqipërinë, kanë dakord që të bashkëpunojnë për të ndërtuar një mekanizëm për tregtinë rajonale, e cila do të mundësojë investitorët e huaj apo vendas për të investuar në tregjet e letrave me vlerë të këtyre vendeve në të gjitha shkëmbimet e tyre.

ZHVILLIME TË TJERA

Vizitë pune në vendet e Balltikut

Në datat 6-12 maj 2012, Kryetarja e Autoritetit të Mbiqëqyrjes Financiare Zj. Enkeleda Shehi dhe Zj. Violanda Theodhori Drejtore e Departamentit të Çështjeve Juridike, morën pjesë në një vizitë pune, organizuar nga Programi për Stabilitet Financiar (PFS Program) i USAID, i cili synon integrimin dhe harmonizimin e tregjeve të kapitalit të vendeve të rajonit. Ky program mbështet bashkëpunimin e Rregullatorëve të vendeve të rajonit për harmonizimin e legjislacionit, si dhe krijimin e një platforme të përbashkët tregtimi mes bursave të vendeve të rajonit si: Sllovenia, Kroacia, Mali i Zi, Bosnja Hercegovina, Serbia, Maqedonia dhe Shqipëria. Krijimi i një mekanizmi për tregtimin rajonal, do t'u mundësojë investitorëve të huaj dhe vendas të investojnë sa më lehtësisht në letrat me vlerë të listuara në bursat e vendeve përkatëse.

Duke synuar rritjen e bashkëpunimit, shkëmbimit të eksperiencës dhe njohjes me praktikën më të mira, PFS organizoi këtë vizitë pune në vendet e Balltikut, ku u diskutuan aspekte teknike dhe ligjore të funksionimit të Bursës Rajonale.

Gjatë vizitës, zyrtarë nga vendet Balltike, referuan mbi eksperiencat e vendeve të tyre dhe dhanë këshilla se mënyra më e mirë për rritjen e aktivitetit të tregut të kapitalit për vendet e vogla, është krijimi i Bursës rajonale. Pjesëmarrësit vizituan departamentet e operacioneve të NASDAQ OMX, depozitarët qendrorë dhe rregullatorët e letrave me vlerë të Lituaniës, Estonisë dhe Finlandës. PFS Program është një program i USAID-it për zhvillimin e sektorit financiar të vendeve të Evropës Juglindore. Një nga fushat ku ky program ka një theks të fortë është tregu i letrave me vlerë. Ky program ka mbështetur bashkëpunimin rajonal

të këtyre vendeve dhe ka kontribuar në krijimin e Memorandumit të Bashkëpunimit (MMoU-së) nënshkruar kohët e fundit dhe që quhet deklarata e bashkëpunimit.

Në bashkëpunim me bursat e Evropës Juglindore, PFS hartoi dokumentin “Platforma për Veprim të Përbashkët e Bursave të Evropës Juglindore”, që u nënshkrua nga CEO e bursave të Evropës Juglindore në ceremoninë e nënshkrimit më 27 mars të këtij viti në Sarajevë.

Të gjithë bursat nga vendet e Evropës Juglindore, përfshirë Shqipërinë, kanë dakord që të bashkëpunojnë për të ndërtuar një mekanizëm për tregtinë rajonale, e cila do të mundësojë investitorët e huaj apo vendas për të investuar në tregjet e letrave me vlerë të këtyre vendeve në të gjitha shkëmbimet e tyre. Në mënyrë që të realizohet kjo, PFS organizoi Study tour që konsistonte në takimin me ekspertë të tregjeve të kapitalit të vendeve të zhvilluara, të Balltikut, me qëllim për të diskutuar aspektet teknike dhe ligjore të kësaj iniciative.

Të ftuar në këtë vizitë ishin përfaqësues nga Rregullatorë të Letrave me Vlerë, Bursave dhe Depozitarëve Qendrorë të vendeve të Evropës Juglindore, përfshirë Shqipërinë, për në vendet e Balltikut: Lituani, Estoni, Finlandë dhe Helsinki.

Kjo vizitë shërbeu për shkëmbim eksperiencash mes vendeve pjesëmarrëse duke dhënë këshilla për të rritur aktivitetin e tregjeve të kapitalit në zhvillim përmes harmonizimit dhe integritit. Në Balltik, ku ka një treg të vetëm, kanë tërhequr investitorë, për domosdoshmërinë e integritit dhe harmonizimit të tregjeve kapitale të vogla në Evropën Juglindore.

Takim rajonal i Autoriteteve Mbikëqyrëse të Sigurimeve të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, si dhe Azisë Qendrore dhe Transkaukasisë, me temë “Mbikëqyrja Makro Prudenciale e grupit”

Në datat 8-10 maj 2012 në Shkup, Maqedoni u zhvillua takim rajonal me temë “Mbikëqyrja Makroprudenciale e grupit” me pjesëmarrjen e Autoriteteve Mbikëqyrëse të Sigurimeve të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore, si dhe Azisë Qendrore dhe Transkaukasisë. Takimi u organizua nga Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS), në bashkëpunim me Institutin për Stabilitet Financiar (FSI) dhe Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë (ISA). Pjesëmarrës në këtë takim ishin edhe përfaqësues nga Autoritetet Mbikëqyrëse Financiare të Bullgarisë, Maqedonisë, Polonisë dhe Shqipërisë. Gjithashtu kishte pjesëmarrës edhe nga Bankat Qendrore të Lituaniës, Serbisë, Republikës Çeke dhe Turqisë. Takimi synoi të adresojë një gamë të gjerë temash mbi menaxhimin e stabilitetit financiar, përjasjen Makroprudenciale, duke përfshirë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit midis mbikëqyrësve, si dhe fushat prioritare të punës së IAIS-it. Ndër tematikat kryesore ishin:

- Monitorimi i riskut dhe stabiliteti financiar;
- Bashkëpunimi mbikëqyrës në rajon;
- Principet e reja bazë të IAIS-it dhe stabiliteti financiar;
- Standardet Ndërkombëtare të IAIS-it mbi mbikëqyrjen me bazë të gjerë të grupit të sigurimit;
- Mbikëqyrja e grupit , krijimi i kolegeve të mbikëqyrësve, roli i palëve të përfshira në kolegje, shkëmbimi i informacionit dhe format e kooperimit;



Pjesëmarrësit në takimin rajonal “Mbikëqyrja Makroprudenciale e grupit”

- Përdorimi i ERM-së (menaxhimi i riskut të entit) dhe praktikata si mbrojtje ndaj krizave të ardhshme financiare;
- Masat e mbikëqyrjes, ndërhyrja e hershme e mbikëqyrësve, sanksionet.

Gjithashtu, gjatë seminarit, pjesëmarrësit të organizuar në grupe pune, bënë prezantime rreth çështjeve të ndryshme të procesit mbikëqyrës dhe më specifiku ishin dy raste studimore, i pari me fokus në identifikimin e problemeve në avancë dhe “Mbikëqyrjen me bazë Risku” dhe rasti tjetër studimor lidhur me “Mbikëqyrjen Makroprudenciale të grupit”. Këto raste studimore identifikuan masat e ndryshme që mund të ndërmerren për parandalimin e një krize të mundshme financiare në një shoqëri sigurimi Jete ndërmjet të cilave: ndalimin e transksioneve huadhënëse në grup, ndryshimi i profilit të riskut nëpërmjet ndryshimit të strategjisë së investimeve, ndryshimi i politikës së marrjes në sigurim, shtimi i kapitalit që do të përdoret në periudhë vështirësie, etj.

Takimi u shoqërua me këmbim pikëpamjesh, idesh, praktika, ku pjesëmarrësit sollën raste konkrete të punës së Autoriteteve Mbikëqyrëse, të cilët ata përfaqësonin.

Takimi synoi të adresojë një gamë të gjerë temash mbi menaxhimin e stabilitetit financiar, përjasjen Makroprudenciale, duke përfshirë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit midis mbikëqyrësve, si dhe fushat prioritare të punës së IAIS-it.

Sot, aktiviteti i sigurimeve po ndryshon nga aktiviteti tradicional dhe në këto kushte organizatat ndërkombëtare janë duke punuar për koordinimin e punës në ndihmë të minimizimit të ndryshimeve mes aktivitetit tradicional të sigurimeve dhe atij jo-traditional.

Zhvillon punimet Forumi Ndërkombëtar i Sigurimeve

Shoqata Kombëtare e Komisionerëve të Sigurimeve (NAIC) zhvilloi gjatë periudhës 10-11 maj 2012, në Washington, SHBA, Forumin Ndërkombëtar të Sigurimeve me pjesëmarrje të Rregullatorëve dhe Industrisë së Sigurimeve. Në këtë Forum, lektorë të shquar nga fusha e sigurimeve shkëmbyen pikëpamjet dhe eksperiencat e tyre mbi shumë çështje aktuale.

Në kushtet e krizës financiare globale, një vend të rëndësishëm pati diskutimi mbi rolin e sektorit të sigurimeve në sistemin financiar dhe në ekonominë reale. Sot, aktiviteti i sigurimeve po ndryshon nga aktiviteti tradicional dhe në këto kushte organizatat ndërkombëtare janë duke punuar për koordinimin e punës në ndihmë të minimizimit të ndryshimeve mes aktivitetit tradicional të sigurimeve dhe atij jo-traditional. Rritja e kooperimit dhe koordinimit mes rregullatorëve mbetet përsëri një çështje e rëndësishme.

Pjesëmarrësit në diskutime treguan edhe njëherë përfitimet dhe sfidat potenciale për të qenë nënshkrues të marrëveshjes së bashkëpunimit shumëpalëshe MMoU dhe të marrëveshjeve bilaterale, si mjet për rritjen e bashkëpunimit mes rregullatorëve.

Mbikëqyrja e aktivitetit të shoqërive grup të sigurimeve ishte pika e diskutimit të një paneli tjetër. U diskutua mbi praktikën aktuale dhe emergjente, si dhe mbi pikëpamjet e ndryshme në lidhje me mbikëqyrjen e grupit, si dhe sfidat me të cilat duhet të përballen rregullatorët e sigurimeve në këtë drejtim. Ndërkohë, IAIS po punon për rishikimin e qasjeve të saj për mbikëqyrjen dhe raportimin e grupeve. Gjithashtu u diskutuan çështjet që lidhen me vlerësimin e kapitalit të grupit dhe përcaktimin në kuadër të Com Frame. Com Frame luan një rol të rëndësishëm në kuadrin e mbikëqyrjes së grupeve tepër të mëdha. Që nga janari 2010, kur IAIS lançoi projektin, Com Frame ka marrë një vëmendje dhe interes të madh, si nga mbikëqyrësit ashtu edhe nga industria e sigurimeve. Com Frame filloi si një iniciativë dhe në vitin e dytë të tij vazhdon të njohë zhvillim.

Në përfundim të Forumit, u diskutua edhe mbi metodologjitë e ndryshme sasiore dhe cilësore për vlerësimin e aftësisë paguese, si dhe mbi procesin e nevojshëm për promovimin, kooperimin, bashkëpunimin dhe koordinimin mes mbikëqyrësve në mbarë botën në kuadër të mbikëqyrjes së grupeve të sigurimeve.

Mbikëqyrja e pensioneve për vendet e Evropës Qendrore, Lindore, Azisë Qendrore dhe Kaukazit

Në datat 10-11 maj 2012 në Shkup, Maqedoni u zhvillua takimi rajonal me temë “Mbikëqyrja e pensioneve për vendet e Evropës Qendrore, Lindore, Azisë Qendrore dhe Kaukazit”. Ky aktivitet u organizua nga Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrjes së Pensioneve (IOPS) me mbështetjen e Organizatës Ndërkombëtare të

Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS). Organizimi i aktivitetit u mbështet edhe nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Pensioneve Vullnetare të Maqedonisë (MAPAS). Takimi ishte i dyti në llojin e vet, i paraprirë nga takimi i parë rajonal i zhvilluar në Turqi, në shkurt 2010.

Në takim u trajtuan tema të rëndësishme në mbikëqyrjen e sistemit të pensioneve private vullnetare që janë fusha prioritare të IOPS-it. Çështjet kryesore të trajtuara ishin:

- Zhvillimi dhe qasja e mekanizmave të mbikëqyrjes me bazë risku të fondeve të pensionit;
- Zhvillimet në sistemet mbikëqyrëse të vendeve të rajonit;
- Ndërtimi i strukturave optimale dhe të praktikave të qeverisjes së mirë për autoritetet mbikëqyrëse të pensioneve;
- Kontrolli i kostove në industrinë e pensioneve private;
- Puna kërkimore në proces e IOPS-it, si dhe puna për hartimin e standardeve dhe parimeve që rregullojnë këtë fushë, etj.

Gjatë takimit u prezantuan edhe disa nga parimet kryesore të IAIS-it, që gjejnë zbatimin e tyre në sektorin e pensioneve vullnetare e që kanë të bëjnë me qeverisjen e korporatave,

investimet, menaxhimin e riskut, si dhe drejtimin e biznesit.

Me interes për të pranishmit ishin prezantimet e mbajtura në panelin mbi zhvillimet e mbikëqyrjes së pensioneve për vendet e rajonit, ku nga përfaqësuesit e AMF-së u prezantuan zhvillimet në mbikëqyrjen e pensioneve vullnetare në Shqipëri. Në prezantimin e mbajtur nga z. Rinald Guri, Drejtor i Departamentit të Kërkimit, TI dhe Statistikës u paraqitën reformat rregullatore, sfidat dhe mbikëqyrja, si dhe zbatimi i mbikëqyrjes me bazë risku në këtë sektor në Shqipëri.

Në takim ishin të pranishëm përfaqësues të vendeve si Armenia, Britania e Madhe, Çekia, Hollanda, Hungaria, Kirgistani, Kosova, Kina, Italia, Maqedonia, Moldavia, Norvegjia, Polonia, Rumania, Sllovakia, Shqipëria, Turqia, si dhe ekspertë të ndryshëm të pavarur, të angazhuar në hartimin e parimeve rregullatore dhe zbatimin e mbikëqyrjes me bazë risku në disa nga vendet e pranishme.

Me interes për të pranishmit ishin prezantimet e mbajtura në panelin mbi zhvillimet e mbikëqyrjes së pensioneve për vendet e rajonit, ku nga përfaqësuesit e AMF-së u prezantuan zhvillimet në mbikëqyrjen e pensioneve vullnetare në Shqipëri. Në prezantimin e mbajtur nga z. Rinald Guri, Drejtor i Departamentit të Kërkimit, TI dhe Statistikës u paraqitën reformat rregullatore, sfidat dhe mbikëqyrja, si dhe zbatimi i mbikëqyrjes me bazë risku në këtë sektor në Shqipëri.

Takimi i tretë rajonal i mbikëqyrësve të tregjeve të sigurimeve të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore

Autoriteti Slloven i Mbikëqyrjes së Sigurimeve në bashkëpunim me Autoritetin Hungarez të Mbikëqyrjes Financiare, zhvilluan në datat 24 - 25 maj në Lubjanë, Slloveni, takimin e tretë rajonal me Mbikëqyrësit e Sigurimeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore.

Kjo iniciativë, e iniciuar në prill të vitit 2011 nga Autoriteti i Tregut Financiar Austriak dhe Autoriteti Hungarez i Mbikëqyrjes Financiare, mbledh

së bashku Autoritetet Mbikëqyrëse të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore, me qëllim promovimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve të ngushta të bashkëpunimit dhe bashkëveprimit mes mbikëqyrësve të sigurimeve në rajon.

Në këtë takim, morën pjesë autoritetet homologe të vendeve si Austria, Bosnje Hercegovina, Hungaria, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Polonia, Rumania, Sllovakia dhe Sllovenia. Tematika e trajtuar në këtë takim

Tematika e trajtuar në këtë takim kishte të bënte me çështje si: ‘ndikimi i zhvillimit dhe ndryshimit të risqeve sistemike në biznesin e sigurimeve’, ‘sfidat e sigurimit të katastrofave natyrore’, ‘mbikëqyrja e degëve’ dhe ‘sfidat në mbikëqyrjen e grupeve’.

kishte të bënte me çështje si: ‘ndikimi i zhvillimit dhe ndryshimit të risqeve sistemike në biznesin e sigurimeve’, ‘sfidat e sigurimit të katastrofave natyrore’, ‘mbikëqyrja e degëve’ dhe ‘sfidat në mbikëqyrjen e grupeve’.

AMF, në këtë takim të nivelit të lartë, u përfaqësua nga Zv/Kryetari, Z. Mati Pepa dhe Z. Rinald Guri, Drejtor i Departamentit të Kërkim, TI dhe Statistikës.

Kjo nismë tashmë mund të konsiderohet e suksesshme, nisur nga interesimi i vazhdueshëm dhe pjesëmarrja aktive e vendeve të rajonit, duke ruajtur dhe nxitur më tej frymën e bashkëpunimit efektiv mbi çështjet dhe problematikat e përbashkëta që hasen në rregullimin e tregjeve të sigurimeve në rajon, me theks shkëmbimin e eksperiencave të vlefshme midis rregullatorëve.

“Mbrojtja konsumatore në sigurime, praktikat më të mira dhe standardet ndërkombëtare”

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, AMF dhe USAID nëpërmjet Programit të Zhvillimit të Sektorit Financiar në Shqipëri, FSVC dhe Programit Rajonal, PFS organizuan në Tiranë në datat 31 maj - 1 qershor workshop-in me temë “Mbrojtja e konsumatorëve në sigurime: Praktikrat më të mira dhe standardet Ndërkombëtare”. Pjesëmarrës në këtë takim ishin specialistë nga Autoritetet e Azerbaxhanit, Bosnje Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë dhe Shqipërisë.



Pjesëmarrësit në takimin rajonal mbi mbrojtjen e konsumatorëve në sigurime

Workshopi u hap nga Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë, znj. Enkeleda Shehi, e cila theksoi rëndësinë e madhe që ka mbrojtja e konsumatorit si një ndër misionet themelore të AMF-së. Programi i këtij workshopi kishte në qendër trajtimin e parimeve bazë të hartuara nga Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS) si edhe prezantimin e praktikave më të mira të vendeve të tjera në rajon dhe në Evropë. Trajnerë të këtij workshopi ishin Znj. Holly Bakke, Drejtore e Iniciativës Strategjike, LLC; Z. Mr. Jorg Heidmann, BaFin, Gjermani; Z. Mihael Perman, Universiteti i Ljubljanes, Sloveni dhe Z. Darko Blazevski, Agjensisë Maqedonase të Mbikëqyrjes së Sigurimeve.

Eksperienca e rregullatorit të Maqedonisë tregonte për fushatat ndërgjegjësuese tek konsumatorët dhe përdorimin e gjerë të faqes së web, ndërkohë që eksperienca Sllovene në mbrojtjen e konsumatorit e lidhte atë me përfshirjen e agjencive të tjera përveç asaj të mbikëqyrjes së sigurimeve. Përfaqësuesi i BaFin, Autoritetit Federal Financiar të Mbikëqyrjes, prezantoi në workshop guidën për mbrojtjen e konsumatorit dhe mënyrat e trajtimit të ankesave të tyre, e cila u prit me interes nga pjesëmarrësit për mundësitë e zbatimit të saj edhe në vendet e tjera.

Gjithashtu, gjatë workshopit, pjesëma-

Workshopi u hap nga Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë, znj. Enkeleda Shehi, e cila theksoi rëndësinë e madhe që ka mbrojtja e konsumatorit si një ndër misionet themelore të AMF-së.

rrësit u organizuan në grupe pune sipas vendeve duke bërë prezantime rreth standardeve që zbatohen aktualisht në vendet e tyre për mbrojtjen e konsumatorit duke shkëmbyer edhe eksperiencat midis tyre. Pjesëmarrësit gjithashtu në fund të workshopit

ndërtuan një projekt - plan për forcimin e mbrojtjes ndaj konsumatorit në sigurime që përfshinte vendosjen e prioriteteve, fushatat e ndërgjegjësimit mediatic në mbrojtje të konsumatorit, përdorimin e medias sociale dhe faqeve të web, etj.

TË REJA NGA RAJONI

GREQI: Tregues në rënie në Sigurimin e anijeve

Një tendencë rënieje e është vërejtur në sigurimin e anijeve në Greqi në vitet e fundit. Sipas të dhënave nga Shoqata Greke e Shoqërive të Sigurimit, HAIC, në 2010 primet e shkruara arritën 15 milionë euro nga 15.6 milion që ishin në vitin 2009. Nga këto prime, 4.1 milion euro llogariten ato për sigurimin e përgjegjësive së anijeve. Ky ndryshim nuk është i rastësishëm, pasi përputhet me tregun e shitjeve të anijeve në Greqi, të cilat kanë pësuar rënie me 26 %, nga 2009 deri në vitin 2010.

Shitja e anijeve deri në 10 metra në

Greqi, të cilat sipas legjislacionit në fuqi konsiderohen anije luksi, është një tregues i rëndësishëm dhe sipas të dhënave ka patur një tendencë rënieje. Në vitin 2007 kishte mbi 12,000 anije të regjistruara, ndërsa në vitin 2011 ky numër ishte rreth 3,500. Kjo ulje është edhe për shkak të recesionit ekonomik. Në Greqi, në përputhje me të dhënat e fundit të publikuara nga HAIC, raporti i dëmeve ishte në masën 60% (në 2009 ky raport ishte 65.8%) dhe shpenzimet operative (ose marrjen në sigurim) ishin në masën 18% (nga 16.8% që ishin në vitin 2009).

Burimi: www.insuranceworld.gr

Ky ndryshim nuk është i rastësishëm, pasi përputhet me tregun e shitjeve të anijeve në Greqi, të cilat kanë pësuar rënie me 26 %, nga 2009 deri në vitin 2010.

RUSI: Viti 2011, ruhet tendenca rritëse

Tregu rus i sigurimeve regjistroi një dinamikë të lartë në vitin 2011, kur vëllimi i primeve të shkruara bruto u rrit me pothuajse 22% ose 1,267.8 miliardë në monedhën vendase RUB, (Rubla).

Sigurimi i jetës kishte më pak se 3% të tregut të sigurimit rus. Primi i shkruar në segmentin e sigurimit të jo-jetës arriti shumën 1,233.15 miliard RUB (29.6 miliard euro) ose 21% më shumë në krahasim me vitin 2010. Sigurimet e detyrueshme llogariten pothuajse 58% të primit të shkruar bruto të jo-jetës, ndërsa diferenca prej 42%, përfaqëson

primin e shkruar për produktet e sigurimit vullnetar.

Sigurimit shëndetësor ka 47.65% të primit të shkruar bruto, të tregut të përgjithshëm. Në vitin 2011 primi për këtë linjë biznesi arriti 604.18 miliardë RUB ose 24.5% më shumë në krahasim me vitin 2010.

Sigurimi TPL përfaqëson vetëm 8.15% të primit të përgjithshëm të shkruar bruto dhe në 2011 shënoi një normë rritje 12.7%, ose në 103.3 miliardë RUB.

Tregu rus i sigurimeve regjistroi një dinamikë të lartë në vitin 2011, kur vëllimi i primeve të shkruara bruto u rrit me pothuajse 22% ose 1,267.8 miliardë në monedhën vendase RUB, (Rubla).

Sigurimi Kasko mban pjesën më të madhe të portofolit të tregut, prej gati 13%. Primet e shkruara për këtë linjë u rritën me 18.5% në vitin 2011, ose në 164.5 miliardë RUB.

Dëmet e paguara nga siguresit rusë arritën 888.4 miliardë RUB ose 15.6% më shumë se viti 2010. Sasia më e madhe i takon sigurimit të detyrueshëm shëndetësor (585.25 miliard RUB).

Vëllimi i primit të shkruar bruto, nga ushtrimi i veprimtarisë së siguresve bullgarë, regjistroi një ndryshim vjetor negativ prej rreth 0.6 %.

BULLGARI: Viti 2011 dhe tendencat e ndryshme

Vëllimi i primit të shkruar bruto, nga ushtrimi i veprimtarisë së siguresve bullgarë, regjistroi një ndryshim vjetor negativ prej rreth 0.6 %. Sigurimi i jetës, me një peshë të qëndrueshme 15.6% të portofolit të tregut, shënoi një rritje prej 1,22% ose 128.7 milion Euro në primin e shkruar bruto. Sigurimet lidhur me investimet, edhe pse me një peshë shumë të vogël në portofolin e tregut, prej vetëm 1.22%, regjistruan një normë rritje nga 55%.

Në sigurimin e Jo-Jetës linjat kryesore, sigurimi motorik dhe sigurimi i pronës regjistruan ndryshime negativ të primit të shkruar bruto, me rreth 1%.

Primi i shkruar bruto për policat e TPL përbënte 32.6% të portofolit të përgjithshëm, ndërkohë në sigurimin kasko vëllimi i biznesit ka vazhduar të ulet në një ritëm prej 10.7%.

Për këtë numër punuan:

*R. Guri, D. Kalaja, V. Theodhori, F. Musta, T. Cani, J. Mele,
L. Lloji, J. Dengeri, Dh. Hazbiu, R. Eltari, E. Kokona*